

KRYETARI I PARË I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT ILJAZ PASHË DIBRA (QOKU)

Kryetari i parë i Lidhjes ka qenë, pikërisht, Iljaz Pashë Dibra (Qoku).¹ Tashmë, në botimin e ri të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar lihen më një anë etiketimet jo të pakta të tij si një nga krerët e moderuar apo konservatorë e, në ndonjë rast, dhe kapitullant të saj. Përballë këtyre pretendimeve del e nevojshme të theksohen si kontributi i tij madhor në themelimin e Lidhjes, ashtu dhe ndihmesa e tij vendimtare në udhëheqje të krahut të saj më përparimtar dhe më të vendosur për sendërtimin dhe zbatimin e programit të saj kombëtar.

Karakterizimi i mësipërm është krejtësisht i pamjaftueshëm për të dhënë të sintetizuar saktësisht figurën e njërit prej organizatorëve kryesorë të Kuvendit themelues të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kryetarit të këtij Kuvendi historik dhe kryetarit të parë të Lidhjes të zgjedhur nga delegatët e tij. Në krye të Këshillit të Përgjithshëm të saj, Iljaz Pashë Dibra, i dalluar që në vitin 1860 në përballimin e sulmeve të forcave shoviniste malaziase në vilajetin e Shkodrës,² dëshmoi vendosmërinë e tij në luftërat për të hedhur poshtë klauzolat e Traktatit të Shën Stefanit dhe vendimet e Traktatit të Berlinit në kurriz të tërësisë së trojeve shqiptare. Ai qëndroi në ballë të Kuvendit dhe të Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes për formulimin dhe parashtrimin e programit autonomist të shqiptarëve. I. Dibra vinte në krye të Lidhjes me përvojën e luftërave që kishte zhvilluar që në moshë fare të re, më 1844, kundër forcave osmane të Hajredin Pashës

¹ Fjalori enciklopedik shqiptar, botim i ri (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), vëll. I, Tiranë, 2008, f. 473.

² H. Stermilli, Dibra në prag të historisë, Tiranë, dorshkrim, 3 prill 1940, Material i shaptilografuar nga Muzeu Historik i Peshkopisë,

dhe përpjekjeve të Portës së Lartë, për zbatimin e reformave centralizuese.³ I pajisur me një vetëdije të re politike, Iljaz Qoku, në qershor të vitit 1878, u vu në ballë të luftës për sendërtimin e planeve për realizimin e autonomisë administrative kombëtare të vilajeteve të bashkuara shqiptare. Me autoritetin dhe prestigjin që gëzonte, punoi energjikisht, pa marrë parasysh moshën, për bashkimin e viseve të tjera shqiptare rreth programit kombëtar të Lidhjes në Kuvendet e Dibrës më 14 tetor 1878 dhe më 10 nëntorit 1880, të kryesuara po prej tij.

Për të provuar sa u tha më sipër, mjafton t'u drejtohem dokumenteve programatike të Lidhjes së Prizrenit, në të cilat Iljaz Pasha është kryefirmëtari i tyre dhe kryetar i kuvendeve në të cilat ato janë miratuar dhe rikonfirmuar në qershor dhe tetor 1878 dhe në nëntor 1880.

Edhe pse përfaqësues vetëm të një pjese të Shqipërisë, të asaj lindore, të rrezikuar nga agresioni sllav, 43 delegatë (38 muslimanë dhe 5 kristianë) të Kuvendit të Prizrenit të mbledhur në Bajrakxhaminë e qytetit, "për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë" vendosën njëzëri në emër të popullit formimin e organizatës kombëtare mbarëshqiptare, Lidhjen e Prizrenit.⁴ Kryetar të saj zgjodhën, jo për merita moshore, atdhetarin e mirënjohur Iljaz Pashë Qokun (Dibrën), figura e të cilit, pak të thuhet, është lënë në hije, edhe sot e kësaj dite.

Qysh më 15 qershor, Iljaz Dibra me kuvendarët i dhanë organizatës së porsakrijuar platformën mbarëshqiptare, programin atdhetar dhe taktikën revolucionare të luftës për ruajtjen e tërësisë së trojeve amtare dhe, në të njëjtën kohë, dhe të luftës për sigurimin e të drejtave kombëtare. Këto dokumente u bënë baza e vetme dhe e sigurt rreth së cilës u bashkuan forcat atdhetare nga vilajetet e tjera, nga të katër anët e viseve shqiptare.

Dokumenti i parë që miratuan delegatët e Kuvendit të Prizrenit të kryesuar nga Iljaz Pasha, ishte Protesta kundër Traktatit të Shën Stefanit dhe çdo projekti të ri të mundshëm për copëtimin e trojeve etnike shqiptare nga Kongresi i Berlinit. Ata deklaruan "në një shpallje të nënshkruar bashkërisht dhe nga krerët

³ Po aty, Iljaz Qoku u internua së bashku me Sheh Mustafa Zerqanin, Haki Hoxhollin e të tjerë, të cilët nuk u kthyen në vendin e vet.

⁴ S. Kılçe. Osmanlı tarihinde Arnavutluk, İzmir 1944, s. 250-251.

e krishterë, se të gjithë shqiptarët ishin të vendosur të përballonin çdo vendim negativ që do të delte nga ai forum i diplomacisë europiane dhe çdo sulm a agresion që do të vinte nga fqinjët". Iljaz Pasha me bashkëmendimtarët e vet së bashku me vendosmërinë për të mos lejuar copëtimin e trojeve amtare, bënë të qartë shqiptarësinë dhe shqiptarinë e tyre:

"Qoftë i mallkuar kush ndjek interesat egoiste në këtë kohë kur atdheu na thërret në shërbim të tij. Ne në Lidhjen tonë vendosëm që para së gjithash të provojmë që, pa diskutuar për fenë, jemi shqiptarë".⁵ Këtë realitet kishte parasysh ato ditë këshilltari i valiut të Kosovës, Pashko Vasë Shkodrani, të cilin ai e ngriti në art në vargjet himn: "Feja e Shqiptarit asht shqiptaria!"

Gjithë këto zhvillime, autori shqiptar që i ka botuar i pari, me sa dimë, këto dokumente, Sulejman Kylçe, i konsideronte qysh më 1944, *"natyrshëm një vepër zgjimi e madhe"*. Dhe, me të vërtetë, vendimet e 15 qershorit 1878 shënuan një hop cilësor, madhor në rrugëtimin e gjatë e të mundimshëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare drejt Pavarësisë

Përfaqësuesit e shqiptarëve nga viset Veriore, Verilindore dhe Lindore, të udhëhequr nga Iljaz Pashë Dibra dhe të frymëzuar dhe e të drejtuar nga Pashko Vasë Shkodrani, shkuan në Kuvendin e Prizrenit me idenë e padiskutueshme të njësisë kombëtare midis shqiptarëve, pa dallime fetare dhe krahinore. Ata e patën të qartë që atë ditë se tërësia e trojeve amtare në të ardhmen nuk mund të sigurohej pa sendërtimin gjithashtu edhe të të drejtave kombëtare në kuadër të vilajetit të bashkuar shqiptar të reformuar në përputhje me traditat historike dhe kërkesat e kohës.

Detyrën e shpëtimit të viseve shqiptare të rrezikuara nga Traktati i Shën Stefanit, të parashtruar në protestën e 15 qershorit 1878, Iljaz Pashë Dibra dhe përfaqësuesit e vilajetit të Kosovës e të sanxhakut të Dibrës në Kuvendin e Prizrenit e panë të pandarë nga synimi politik për sigurimin e të drejtave kombëtare në kuadër të bashkimit të trojeve shqiptare me një autonomi sa më të gjerë. Konkretisht dhe shprehimisht ata në Programin Autonomist të 15 qershorit 1878 kërkuan:

Krijimin e një administrate autonome nën emrin "vilajetet e bashkuara" (Tevhid-i vilayat) me qendër Manastirin dhe caktimin,

⁵ Po aty.

përkohësisht, të Gazi Ahmet Muhtar Pashës (heroi i Luftës ruso-turke nuk do t'i justifikojë shpresat që delegatët e Kuvendit historik patën tek ai), kryetar të Vilajeteve të Bashkuara; Angazhimin për krijimin e Këshillave të Lidhjes me detyrë përhapjen e qëllimeve për autonomi në qendrat e mëdha si Manastiri, Shkupi, Prishtina; Mbledhjen e taksës së asharit dhe të vergjisë, për bagëtinë dhe për pronat, në emër të Vilajeteve të Bashkuara, duke organizuar për këtë qëllim dhe xhandarmërinë. Së fundi, shtrohej si detyrë krijimi i milicisë ushtarake për mbrojtjen e territorit që do të përfshihej në « Vilajetet e Bashkuara ».^{6]}

Miratimi i këtyre kërkesave nga Iljaz Dibra dëshmon katërcipërisht se Pashaj, dhe jo vetëm ai, kishte përvetësuar në ato ditë vendimtare për fatet e atdheut pikëpamjet më të përparuara të përfaqësuesve më largpamës të Rilindjes. Pavarësisht se nuk kemi të dhëna rreth formimit të tij arsimor, del qartë se Iljaz Qoku nuk qe një përvetësues pasiv i mendimit më të përparuar politik të Rilindjes. Me përvojën dhe vendosmërinë e tij ai kontribuoi, të paktën, në shndërrimin e tij në program pune të Lidhjes së krijuar prej 43 delegatëve të Kuvendit të Prizrenit dhe të udhëhequr për afro dy vjet prej tij. Edhe kur nuk qe kryetar i Lidhjes, ai vijoi me vendosmëri luftën për realizimin e këtij programi.

Protesta e parë e Lidhjes së Prizrenit si dhe Programi autonomist i saj përçonin në mënyrë koncize idetë e shprehura në Përkujtesën e Shkodrës drejtuar dy ditë më parë lordit Bikonsfild, dokument i nënshkruar nga Pjetër Gurakuqi dhe Daut Boriçi dhe dhjetëra e dhjetëra qytetarë.^{7]} Me parashtrimin e kërkesës programore për pavarësi, dhe të kërkesës alternative për autonomi të shkodranëve, më 13 qershor 1878 nuk delte detyra për avancimin, por për vënien e saj në themelet e lëvizjes së fuqishme popullore që po ngrihej në pranverë të vitit 1878.^{8]}

Këtë detyrë e kryen pa asnjë mëdyshje Iljaz Pasha dhe

^{6]} Po aty.

^{7]} Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912 (Memorandume, vendime, protesta, thirrje), Përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë, 1978, f. 27.

^{8]} G. Shpuza, Programi final i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Mbjatur si kumtesë në Seminarin IV Ndërkombëtar « Shkodra në shekuj », më 20-22 nëntor 2000 dhe botuar në aktet e Seminarit, vëll. I, Shkodër, 2002, f. 137-148. Botuar i plotë në «Perla», 1-2/2000

delegatët e tjerë të Kuvendit, si dhe përfaqësuesit e viseve të tjera, që arritën në Prizren njeri pas tjetrit për të miratuar dokumentet themeluese të Lidhjes dhe për t'u angazhuar për vënien e tyre në jetë.

Aktet programatike të Kuvendit të Prizrenit u ngritën mbi ndarjet fetare dhe krahinore të trashëguara. Në të nuk u shtruan as për diskutim (megjithëse në të morën pjesë pas pak dhe i miratuan ato dokumente dhe delegatë nga Mirdita), kërkesa separatiste si ajo që Pashaj osman Preng Bib Doda dhe bajraktarët e Mirditës të një besimi me mirditorët që shkuan në Prizren, i parashtruan Kongresit të Berlinit për ruajtjen e privilegjeve fetare dhe ngushtësisht lokaliste të krahinës së Mirditës.⁹

Programin autonomist të Lidhjes, S. Kylçe e konsideron, jo pa të drejtë, « *Kushtetuta e Lidhjes* »¹⁰ Dhe ajo, në të vërtetë, qe kushtetuta e Vilajeteve të Bashkuara dhe projektskica e kushtetutës së Vilajetit Shqiptar autonom.

Janë pikërisht përfaqësuesit e popullsisë shqiptare të Vilajetit të Kosovës dhe të Sanxhakut të Dibrës, nismëtarë të lëvizjes për sendërtimin e idesë për themelimin e Lidhjes, ide e cila kishte lindur dhe qe përhapur në rrethet e gjera atdhetare. Qenë Iljaz Pashë Dibra dhe bashkëmendimtarët e tij, të cilët, duke folur në emër të mbarë popullit shqiptar, i dhanë Lidhjes, qysh në fillimet e saj, programin atdhetar të luftës për ruajtjen e tërësisë së trojeve amtare dhe të luftës për sigurimin e të drejtave kombëtare në shkallën e një autonomie politiko-administrative në kuadër të Perandorisë Osmane. Këtë detyrë ata e kryen, me që koha nuk premtonte, pa prituri ardhjen e përfaqësuesve të viseve të tjera. Prandaj dhe delegatëve të vilajeteve të Shkodrës dhe të Janinës nuk u mbetej tjetër veçse të bashkoheshin njëri pas tjetrit me besim të plotë rreth programit të nismëtarëve dhe themeluesve të Lidhjes së Prizrenit, duke u bërë realisht bashkënishtarë dhe bashkëthemelues të saj. Kështu ata i dhanë asaj, jo vetëm në letër, karakterin mbarëshqiptar.¹¹

⁹ Akte ... f. 21-28

¹⁰ S. Kylçe, po aty.

¹¹ G. Shpuza, Aktet themeluese të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (15 qershor 1878), kumtesë e përgatitur për Konferencën shkencore kushtuar 120-vjetorit të Lidhjes, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, qershor 1998. Organizatorët nuk e përfshinë në program. Ajo u përfshi në botimin «Kuvendime për historinë kombëtare», Tiranë, 2000, f. 94-97

Programi i Lidhjes së Prizrenit i 15 qershorit u mbështet fuqimisht, i argumentuar dhe më i plotë në Kuvendin e Dibrës, të kryesuar po nga Iljaz Pasha, më 14 tetor 1878. Në të u çuan më tej edhe idetë e Programit dhe u parashtrua që të gjitha viset e Shqipërisë të përmbliidhen në një vilajet dhe të caktohet si qendër një qytet që të kishte lidhje me çdo anë të tij; nëpunësit që do të shërbenin në Shqipëri duhej të dinin edhe gjuhën shqipe; të përhapej arsimi dhe në shkolla të mësohej edhe gjuha shqipe; të zbatoheshin vendimet që do të merreshin për reformat e dobishme për shtetin dhe kombin nga ana e kuvendit të përgjithshëm, i cili do të mbliidhej një herë në katër muaj çdo vit në qendrën e vilajetit; të ndahej një sasi e mjaftueshme nga të ardhurat e vilajetit për arsimin dhe ndërtimet publike.^{12]}

Ato ditë, në programin autonomist të porsamiruar në Dibër për krijimin e vilajetit shqiptar aderuan dhe krahinat jugore përmes Lidhjes Shqiptare për Toskërinë, të përfaqësuar nga Abdyl Frashëri e të tjerë.^{13]} Pjesëmarrja e tyre aktive në Kuvendin e Dibrës përforcoi karakterin e Lidhjes si një organizatë politike mbarëshqiptare, ashtu siç qe përcaktuar qysh në ditën e parë të themelimit të saj. Sipas dokumenteve që ndodhen në Arkivat e Stambollit, Iljaz Pasha i nënshkroi dhe një herë ato pesë kërkesa, kësaj here së bashku me Abdylin, më 2 nëntor 1878. Dokumenti i ri përmbyllej me dy paragrafë kuptimplotë:

“Derisa të arrihet plotësimi dhe realizimi i këtyre kërkesave, të cilat janë në interes të kombit dhe të shtetit, të gjitha krahinat e Shqipërisë do të qëndrojnë në një fjalë dhe kompakt, të bashkuar me një zë dhe për këtë qëllim nuk do të lënë pa përdorur çdo mjet që kanë.

Çdo njeri që do të jetë kundër kërkesave, nuk do të konsiderohet shqiptar, por para të gjithëve njëherit do të llogaritet si armik i atdheut dhe i popullit tone”.^{14]}

Këta paragrafë ishin paralajmërim për elementët e moderuar

^{12]} Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane (1878-1881), Dokumentet i shqipëroi dhe i komentoi Iljaz Rexha, Prishtinë, 1878, f. 44-45.

^{13]} Po aty, f. 46-48.

^{14]} Po aty, 47.

në gjirin e Lidhjes jo vetëm në veri të vendit, por dhe në jug të tij, të prirur për t'u kënaqur me plotësimin e kërkesave më të kufizuara. Turkulogu i mirënjohur nga Prishtina, Iljaz Rexha, i cili e ka botuar dokumentin, vë në pah se në formulimin e mësipërm është arritur me kontributin e veçantë të Degës së Lidhjes Shqiptare për Dibrën.¹⁵ Këtë pohim të drejtë ai e bën i ndodhur përballë heshtjes dhe minimizimit të kontributit të Iljaz Pashës dhe të bashkëqytetarëve të tij, duke evidentuar njëkohësisht në vëllimin e tij me dokumente, dhe rolin e përfaqësuesve të krahinave të tjera, në mënyrë të veçantë të atyre të Toskërisë. Dhe kontributi shumë i madh i Abdyl Frashërit në Kuvendet e Dibrës shkon përtej përfaqësimit të Toskërisë në to në përputhje me karakterin kombëtar dhe mbarëshqiptar të Lidhjes. Nuk ka kurrfarë diskutimi që ai ka dhënë ndihmesën e vet me peshë në formulimin e rezolutave të Kuvendeve të Dibrës më 1878 dhe 1880.

Kërkesa e Lidhjes, e 15 qershorit 1878, për autonomi mbeti mbizotëruese gjatë gjithë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, sepse kushtet ndërkombëtare që e diktuan atë në Kongresin e Berlinit, nuk ndryshuan për 34 vjet. Kemi parasysh marrëveshjen e njëzëshme të fuqive europiane për ruajtjen e *status quos*, gjendjes ekzistuese politike, në Europën Juglindore.

Delegatët e Kuvendit të Prizrenit, të udhëhequr nga Iljaz Pasha, jo vetëm kishin përqafuar idetë më përparimtare të Rilindjes Kombëtare për t'i hapur rrugën krijimit të shtetit kombëtar shqiptar. Në të në të njëjtën kohë, ata u bënë dhe përçues të këtyre ideve në shtresa të gjera të popullit. Shfletimi i dokumenteve programore të Lidhjes së Prizrenit, të miratuara dhe të shpallura në dhjetëditëshin e dytë të muajit qershor të vitit të vullshëm 1878, dëshmon katërcipërisht në mënyrë krejtësisht të padyshimtë, që këto ide kishin depërtuar në Vilajetin e Kosovës, në sanxhakun e Dibrës dhe në vilajetin e Shkodrës, duke mbizotëruar në Kuvendin historik të Prizrenit.

Përkras Iljaz Pashës dhe kuvendarëve të Prizrenit veproi aktivisht ato ditë Pashko Vasë Shkodrani, i mbështetur në përvojën politike e administrative dhe në veprimtarinë e gjerë shkencore

¹⁵ LSh.P në dok. Osm. (1878-1881), Përg. Nga I. Rexha, Prishtinë, 1978, f. 47.

e publicistike. Ai u shpreh në mbrojtje të çështjes shqiptare në mënyrë lapidare në promemoret e tij drejtuar vetëm apo dhe me shokë të tjerë diplomatëve të huaj. Pashkoja me Iljaz Pashën në krah, mbështetur në kulturën aksidentale, përpunonte idetë europiane dhe i materializoi në dokumentacionin programatik të Lidhjes. Me to, Pashko Vasa dhe Iljaz Pasha sollën në Kuvendin e Prizrenit ide të reja dhe një ideal të ri. Ata së bashku me gjithë kuvendarët e Prizrenit mundësuan krijimin e qendrës së Lidhjes mbarëshqiptare të Prizrenit, nga e cila u varën, pavarësisht nga vështirësitë dhe pengesat organizative, të gjitha degët në mbarë qytetet shqiptare që nga Shkodra në Shtip të Maqedonisë së sotme dhe deri në Prevezë dhe në Janinë, përfshijë dhe fshatra të thella si Frashëri.

Ato ditë të qershorit, shqiptarët arritën një nga marrëveshjet më madhore, historike mes vetes, me njëri-tjetrin. Për të mbërritur deri aty, ata kapërcyen politikisht pasojat e prapambetjes ekonomike të shkaktuar nga sundimi i gjatë osman; kapërcyen përçarjen krahinore dhe veçanërisht pasojat e dasive fetare. Paritë çifligare e bajraktare u ngritën mbi separatizmat e tyre karakteristike.

Pashko Vasa, në ato ditë të qershorit të vitit 1878, ua bënte të qartë diplomatëve të Europës në Stamboll dhe në Rumeli se Lidhja e udhëhequr efektivisht nga Iljaz Pasha po fliste me forcë me gjuhën e aspiratave europianiste!¹⁶

Që në fillimet e vitit 1880, në Prizren dhe në Dibër pushteti fiskal dhe ai gjyqësor po kalonin në duart e degëve të Lidhjes Shqiptare. Aksioni po shërbente si shtysë për sendërtimin në mbarë Shqipërinë të kërkesës së parashtruar në Dibër rreth dy vjet më parë për krijimin e Vilajetit autonom shqiptar. Sigurisht që marrja e një vendimi të tillë nuk ishte e lehtë. Mendimet për dhe kundër zienin në Prizren, Shkodër, Dibër, Janinë, Gjirokastrë dhe në të gjitha degët e Lidhjes. Qendër e këtyre debateve jo rastësisht u bë qyteti i Dibrës, jo vetëm për pozicionin strategjik të rajonit, por dhe për rolin e degës së Lidhjes në këtë qytet dhe të autoritetit të njërit prej themeluesve të Lidhjes dhe deri vonë kryetari i saj, Iljaz Pashë Dibrës. Aty u vendos të zhvillohej një Kuvend i ri i Lidhjes. Për këtë qëllim, nga Prizreni erdhi një pjesë e

¹⁶ Akte..., f. 66-68.

krerëve të Lidhjes Shqiptare me në krye Ali Pashë Gucinë. Që atje ata ua përsëritën ftesat gjithë degëve për dërgimin e delegatëve për të marrë pjesë në kuvendin e ri për shpalljen e autonomisë.¹⁷

Sipas konsullit britanik në Selanik, Blant, rreth zhvillimit të punimeve të Kuvendit të Dibrës ishte interesuar dhe arbëreshi Pjetro Kjara, i njohur tashmë si pjesëmarrës aktiv në hapat madhorë që po hidhte Lëvizja Kombëtare Shqiptare me parashtrimin e kërkesës për pavarësi në memorandumun e mirënjohur të shkodranëve drejtuar lordit Bikonsfild më 13 qershor 1878.

Valiu i Kosovës dhe vetë Porta e Lartë u angazhuan seriozisht për ta sabotuar mbajtjen e Kuvendit të Dibrës. Të bindur që "... në se nuk veprohet një orë e më parë, atëherë Shqipëria do të na dalë prej doret...", ata planifikuan dërgimin nga Stambolli në Shqipëri të funksionarëve të lartë dhe të dijetarëve islamë për të penguar mbajtjen e Kuvendit.¹⁸ Pavarësisht nga trysnia e autoriteteve administrative osmane, ushtarake dhe klerikale, në nivel lokal dhe qendror kuvendi arriti të mbahet dhe detyra e të dërguarve të Stambollit tashmë ishte të mos lejohej bashkimi i shqiptarëve rreth platformës së Lidhjes së Prizrenit.

Nën kryesinë e Iljaz Pashë Dibrës, në Kuvend u diskutuan tri çështje vendimtare për momentin për mbarë popullin shqiptar: qëndrimi ndaj çështjes së mbrojtjes së Ulqinit, krijimi i Vilajetit autonom të Shqipërisë dhe formimi i qeverisë së përkohshme.

Shumica e delegatëve të kuvendit u shpreh me vendosmëri për mbrojtjen e Ulqinit në kundërshtim me urdhrin e sulltanit për dorëzimin e tij. Komiteti Ndërkrahinor i Shkodrës u njoftua rreth gatishmërisë së banorëve të Dibrës për dërgimin e forcave vullnetare nga sanxhaku i tyre.¹⁹

Autoritetet osmane, nëse nuk mundën ta pengonin shqyrtimin e çështjes së vilajetit autonom, arritën t'i përçanin delegatët e Kuvendit të Dibrës. Si rrjedhim, u miratuan dy rezoluta. Elementët e vendosur, të udhëhequr nga Iljaz Pasha, Ali Pashë Gucia dhe Esat Pashë Tetova, kërkuan nga Stambolli krijimin e Vilajetit autonom të Shqipërisë. Krahu i moderuar, i cili mori më shumë vota, kërkoi krijimin e një ejaleti të Shqipërisë, në të cilin

¹⁷ Historia e popullit shqiptar, vëll. II, f.202.

¹⁸ I. Rexha, f.80-81.

¹⁹ Historia e popullit shqiptar, Tiranë, 2002, f.202.

të zbatoheshin reformat për organizimin e vilajeteve sipas nenit 23 të Traktatit të Berlinit. Pas mbarimit të punimeve të Kuvendit, më 4 nëntor 1880, i biri i Iljaz Pashës u nis për në Stamboll, siç raportonte konsulli britanik prej Selanikut, Blant, “me një projekt me të cilin kërkohen sanksione, të cilat sigurisht nuk do të pranohen nga sulltani”.^{20]} Me gjithë shpresat e shqiptarëve se Porta e Lartë nuk do ta refuzonte kërkesën për autonomi, të dy rezolutat mbetën pa përgjigje.

Edhe nga sa parashtruam më sipër, del plotësisht e qartë se, në kundërshtim me pohimet dhe karakterizimet shpesh nihilizuese, në fund të fundit minimizuese, që janë bërë dhe bëhen rreth personit të Iljaz Pashë Dibrës, si një nga figurat konservatore apo të moderuara e deri dhe kapitullante të udhëheqjes së Lidhjes së Prizrenit, nuk qëndrojnë. Çifligari dhe sipërmarrësi i madh i taksave, Iljaz Pashë Qoku, qëndroi në radhët e para të udhëheqësve më të përparuar dhe më të vendosur të luftës së popullit shqiptar në vitet 1878-1881. Në krye të Lidhjes ai së bashku me Pashko Vasën, Ali Pashë Gucinë, pasuesin e tij në krye të Lidhjes, Omer Prizrenin,^{21]} Abdyl bej Frashërin, Daut Boriçin, Hodo Sokolin e dhjetëra-dhjetëra të tjerë në ballë të Lidhjes dhe të degëve e të forcave të saj luftarake dhe, më së fundi, dhe të organeve të qeverisë, me kryeministër Omer Prizrenin, vunë gurin më të parë dhe më madhor në themelet e Pavarësisë.

Literatura e shfrytëzuar

- Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912 (Memorandume, vendime, protesta, thirrje), Përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë, 1978.

- Fjalori enciklopedik shqiptar, botim i ri (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), vëll. I, Tiranë, 2008.

- H. Stërmilli, Dibra në prag të historisë, Tiranë, dorëshkrim, 3 prill 1940, Material i shaptilografuar nga Muzeu Historik i Peshkopisë.

^{20]} M. Kodra, Dibra me rrethinë në kohën e Lidhjes së Prizrenit, në “Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881 (12-28 qershor 1878), I, Tiranë, 1979,

^{21]} M. Piraku, Myderriz Ymer Prizreni, ora, zemra dhe shpirti i Lidhjes shqiptare 1877-1887, Sharr, 2003.

- G. Shpuza, Programi final i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Mbajtur si kumtesë në Seminarin IV Ndërkombëtar « Shkodra në shekuj », më 20-22 nëntor 2000 dhe botuar në aktet e Seminarit, vëll. I, Shkodër , 2002, f. 137-148. Botuar i plotë në «Perla», 1-2/2000.

- G. Shpuza, Aktet themeluese të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (15 qershor 1878), kumtesë e përgatitur për Konferencën shkencore kushtuar 120-vjetorit të Lidhjes, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, qershor 1998. Organizatorët nuk e përfshinë në program. Ajo u përfshi në përzgjedhjen me punime të mija «Kuvendime për historinë kombëtare», Tiranë, 2000.

- Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), I, II, Tiranë, 1979, 1980.

- Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane (18878-1881), Dokumentet i shqipëroi dhe i komentoi Iljaz Rexha, Prishtinë, 1878.

- Historia e popullit shqiptar, vëll. II, Tiranë, 2002.

- M. Kodra, Dibra me rrethinë në kohën e Lidhjes së Prizrenit, në “Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881 (12-28 qershor 1878), I, Tiranë, 1979.

- M. Piraku, Myderriz Ymer Prizreni, ora, zemra dhe shpirti i Lidhjes shqiptare 1877-1887, Sharr, 2003.

- S. Kylçe. Osmanli tarihinde Arnavutluk, Izmir 1944, s. 250-251.